



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.11.2019, ora 15:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Nimet Musaj dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Halit Valteri, Andrea Marto, Lefter Koka, Kujtim Gjuzi dhe Zef Shtjefni.

Të ftuar:

Ervin Harxhi – zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Niko Peleshi – Mirëdita,

Kjo është mbledhja për miratimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Relatori do të bëjë një prezantim përmbledhës, nisur edhe nga dëgjesat e katër ministrive të dy ditëve të fundit. Kemi prezent zëvendësministrin e Financave dhe Ekonomisë. Nëse do të jeni dakord, pas fjalës së zotit Beqaj, të kalojmë në votimin në parim.

Zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Bazuar në diskutimet e bëra, përveç prezantimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me Ministrinë e Bujqësisë, me Ministrinë e Turizmit dhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, rezulton e nevojshme të kemi të paktën 5 miliardë lekë më shumë në pjesën e investimeve.

Unë kam disa pyetje për Ministrinë e Financave:

Çfarë ndodh me deficitin buxhetor nëse i rrisim investimet publike me 5 miliardë lekë më shumë?

Çfarë ndodh me balancën primare?

Sa do të rriten shpenzimet e borxhit?

Çfarë efekti mund të ketë vitin e ardhshëm në tregtimin e Eurobondit?

Ervin Harxhi – Nuk diskutohet që një rritje e investimeve apo shpenzimeve do ta prekë në të njëjtën masë balancën primare, deficitin buxhetor dhe nivelin e borxhit. Efekti që do të japë ky shpenzim i tepërt prej 5 miliardë lekësh do të jetë në rangun 0,4%-0,5% tek të dy treguesit që përmendët ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ngelet pozitive, por reduktohet me 0,4%-0,5%. I njëjti efekt do të jetë edhe te borxhi në përqindje.

Tek interesi është një llogaritje më e komplikuar, por nuk diskutohet që do të ketë një efekt negativ në rritjen e shërbimit të borxhit dhe të interesave që lidhen me të.

Për sa i përket pikës së katërt që ju përmendët, efektet në Eurobond vitin tjetër, do të thosha se duke qenë se ne kemi një narrativë të ecurisë së të gjithë treguesve makrofiskalë, çdo devijim nga kjo narrativë, e cila është në trendin përmirësues dhe me targete të rëna dakord me të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë, kjo do të sillte një prishje të kësaj narrative, e cila do të ndikonte negativisht në procesin e Eurobondit. Pra, refinancimi i borxhit do të kishte një efekt negativ, në përgjithësi, dhe Eurobondi në veçanti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të ishte më e kushtueshme, më e vështirë, dhe aktorët, të cilët kanë qenë të përfshirë edhe në procesin e mëparshëm që patëm me Eurobondin, do të ndikoheshin negativisht në pritshmëri, sepse do të jetë një devijim nga parashikimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të matet sa do të jetë kostoja financiare, por një devijim me 5 miliardë, qoftë edhe më pak, do të ishte i papranueshëm për Ministrinë e Financave për shumë aspekte, sepse ka edhe ndikime të tjera indirekte, që nuk janë direkte të matshme, por do të jenë rrjedhojë e ndryshimeve, që mund të sjellin ndikim në shifrat e punësimit apo në indikatorë të tjerë.

Ilir Beqaj – 5 miliardë lekë investime publike do të japin minimalisht 1,3 miliardë më shumë të ardhura, sepse deficitin neto nuk është 5, por 3,6-3,7. Pra, 0,1 kursehet vetë.

Unë do të thosha të anasjelltën e asaj që thatë ju për punësimin. Bëhet fjalë për veprat publike. U kërkua të fillohet hekurudha. Hekurudha nuk është një super teknologji, por ka *labour intensive*. Vazhdimi i rrugës Qukës-Qafë Plloçë ka edhe shumë lëndë të para shqiptare, ka edhe fuqi punëtore. U kërkua edhe mbyllja e rrugës Korçë-Ersekë.

Unë nuk do të thosha se 5 miliardë më shumë investime janë automatikisht 5 miliardë më shumë deficit, sepse, të paktën 1,2-1,3, janë të ardhura. 1,6 është TVSH-ja, plus taksat e punës. Nuk po e quaj tatim-fitimin, sepse ndoshta mund të dalë pas 2 vjetësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E mora përgjigjen dhe jam i qartë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti zëvendësministër, keni ndonjë reagim tjetër? Nuk ju bindi argumenti i dytë?

Ervin Harxhi – Këta tregues makroekonomikë janë parë me shumë kujdes dhe është arritur në rezultatin që kemi me të ardhurat dhe shpenzimet. Çdo prishje e balancave makro do të ndikonte për keq në disa tregues. Nuk mund t'i parashikojmë të gjitha risqet. Ne mund të ulemi, të bëjmë një studim më të thelluar se sa do të ishte ndikimi në shumë tregues për 5 miliardë apo për çdo 1 miliard të shtuar. Pra, mund ta bëjmë si projeksion se sa ndikohen secili nga këta tregues për çdo miliardë, por ka shumë efekte indirekte, të cilat ndonjëherë janë të paparashikueshme dhe të pamatshme.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Pikërisht këtë gjë doja të thosha edhe unë. Ne jemi Komision i Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit dhe sigurisht që kemi për detyrë të

mbështesim iniciativat apo ministritë, të cilat, në një farë mënyre, drejtohen te ne. Ne nuk jemi specialistë të Financave, kështu që nuk dimë të themi me saktësi se çfarë ndikimi ka një shifër apo një shifër tjetër. Ne dimë që sot na mungojnë disa lekë në këto veprimtari që mbulojmë. Ndoshta një studim i tillë, që të dimë se çfarë ndikimi ka 1 miliardë më shumë apo më pak, ne do të na ndihmonte, por unë gjykoj, kryetar, të bëjmë propozimet tona kur të kalojmë nen për nen dhe më pas ta shikojë Komisioni i Ekonomisë nëse është mundur, apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por nuk e di nëse mund të bëhet kjo.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord.

Keni diskutime të tjera? Nuk keni.

Kalojmë në votim në parim për projektligjin e vitit 2020. Kush është dakord në parim? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Me 2 vota kundër, miratohet në parim projektbuxheti i vitit 2020.

Faleminderit!

Nesër kemi në shqyrtim projektligjin e jodit dhe një marrëveshje. Pra, kemi dy mbledhje nesër në orën 10:00.

MBYLLET MBLEDHJA